



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 18, DATË 21 / 11 /2024

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR
PROJEKTIN E INVESTIMIT “LUXORY HOTEL GOLEM” ME SUBJEKT
APLIKUES ADRIATIC LUXURY HOTELS SHPK NUIS M31809035J**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI SE:

- Projekti i investimit parashikon zhvillimin e strukture turistike, i cili konsiston në ndërtimin e një hoteli me 250 (dyqind e pesëdhjetë) dhoma së bashku me ambiente shërbimi si dhe restorante.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 50, 000,000 Euro (pesëdhjetë milion) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 90 (nëndhjetë) punonjës.
- Projekti do të realizohet në një sipërfaqe totale zhvillimi prej afërsisht 1,7 ha, pronë shtetërore dhe private, në ZK 2291, fshati Golem, Bashkia Kavajë.
- Projekti synon të realizohet nga subjekti Adriatic Luxury Hotels shpk NUIS M31809035J.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Luxory Hotel Golem”, me subjekt investues Adriatic Luxury Hotels shpk NUIS M31809035J, ZK 2291, Bashkia Kavajë në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Sipërfaqja ku synohet të shtrihet projekti është e llojit “pyll” dhe këto pasuri duhet t’i nënshtrohen procedurës së heqjes nga “fondi pyjor” dhe/ose ndryshimit të kategorisë së përdorimit. Miratimi i këtij projekti kërkon ndryshime përkatëse të parametrave të zhvillimit të zonës si rishikim të Planit të Përgjithshëm Vendor Kavajë ose hartim Planit të Detajuar për Zonat me Rëndësi Kombëtare (PDZRK).
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
LAURA PLAKU (SARO)